



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial
Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.15 dhe 1.17 dhe nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) dhe të nenit 11 dhe nenit 14 të Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 17 publikuar me 30 qershor 2015), në mbledhjen e mbajtur me datë 29 dhjetor 2015, miraton:

RREGULLORE NR. 12/2015

Për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të performancës së prokurorëve, si dhe mandatin dhe përbërjen e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.
2. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë prokurorëve në Republikën e Kosovës dhe ka të bëjë me vlerësimin e performancës së prokurorëve me mandat fillestar pas trajnimit fillestar, vlerësimin e performancës së prokurorëve në fund të mandatit fillestar dhe vlerësimin e rregullt të prokurorëve me mandat të përhershëm.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- "KPK" Këshilli Prokurorial i Kosovës.
"KVPP" Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve
"ZKPSH" ... Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
"Ligji" Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
"KPSH" Kryeprokurori i Shtetit.
"NJSHP" Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve
"PSRK" Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.
"IGJK" Instituti Gjyqësor i Kosovës

Neni 3 Parimet e Vlerësimit

1. Vlerësimi i prokurorëve bëhet në pajtim me parimin e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit, transparencës dhe garantimit të mundësive të barabarta dhe të drejta për zhvillimin e karrierës së prokurorëve.
2. Vlerësimi do të kontribuojë në sigurimin e llogaridhënies në sistemin prokurorial si dhe të ngritë integritetin, efektivitetin dhe cilësinë e prokurorëve.
3. Vlerësimi nuk ndërhyt në pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorëve.

Neni 4 Periudha e Vlerësimit

1. Vlerësimi i performancës së prokurorëve bëhet për prokurorët me mandat fillestar dhe për prokurorët me mandat të përhershëm.
2. Vlerësimi i prokurorëve me mandat fillestar kryhet një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar.
3. Vlerësimi i parë i performancës së prokurorit pas trajnimit fillestar përfshinë periudhën nga muaji i trembëdhjetë (13) deri në muajin njëzetedy (22) të punës së tij si prokuror, ndërsa vlerësimi i dytë i performancës së prokurorit me mandat fillestar përfshinë periudhën nga muaji njëzetetre (23) deri në muajin tridhjetedy (32).
4. Vlerësimi i rregullt i të gjithë prokurorëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tri (3) vite. KPK cakton me short një të tretën (1/3) e prokurorëve, brenda secilës prokurori, si grupin e parë të cilët do t'u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej tre (3) muajsh. I njëjti short mbahet pas një (1) viti për të caktuar prokurorët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë dhe grupin e tretë pas dy (2) viteve, respektivisht.
5. Njësitë për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorëve (NJSHP) përgatitë listën e prokurorëve që do të vlerësohen për çdo vit paraprak pas konsultimit me Kryetarin e KVPP.

Neni 5 Kriteret e Vlerësimit

1. Vlerësimi i performancës së prokurorëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për KPK-në dhe me këtë Rregullore.
2. Kriteret për vlerësimin dhe promovimin e prokurorëve përfshinë por nuk kufizohen në:

- 2.1 Njohuritë ligjore;
 - 2.2 Aftësinë profesionale;
 - 2.3 Zotësinë për arsyetim ligjor;
 - 2.4 Aftësinë dhe zotësinë për analizimin e problemeve ligjore;
 - 2.5 Aftësinë e komunikimit;
 - 2.6 Paanshmërinë, drejtësinë dhe integriteti, dhe
 - 2.7 Pjesëmarrjen në trajnime.
3. Për Kryeprokurorët përveç kritereve për vlerësim nga paragrafi 2 i këtij neni, konsiderohen edhe treguesit shtesë në vijim që do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e aftësive menaxhuese dhe organizative dhe përvojës së tyre:
- 3.1 Kapaciteti për trajtimin e lëndëve të caktuara;
 - 3.2 Aftësitë organizative;
 - 3.3 Aftësitë menaxhuese dhe udhëheqëse;
 - 3.4 Shfrytëzimi efektiv i burimeve, siç janë buxheti, objektet ose pajisjet;
 - 3.5 Aftësia për caktimin e objektivave dhe implementimin e tyre;
 - 3.6 Aftësitë për zgjidhjen e problemeve, posaçërisht problemeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale.
4. Për prokurorët me detyra menaxheriale (Udhëheqësit e Departamenteve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë) do të zbatohen treguesit e renditur në nënparagrafët 3.1, 3.2, 3.4 dhe 3.5.

Neni 6 Burimet e Informacionit

1. Gjatë procesit të vlerësimit të performancës nga ana e KVPP do të përdoren burime të informacionit që përfshijnë:
 - 1.1 Dosjen personale të prokurorit;
 - 1.2 Raportin Vlerësues të Kryeprokurorit;
 - 1.3 Raportet vjetore të Kryeprokurorëve;
 - 1.4 Raportin e Vetëvlerësimit të Prokurorit;
 - 1.5 Rastet e zgjedhura në mënyrë të rastësishme;
 - 1.6 Procesverbalet e zgjedhura në mënyrë të rastësishme nga seancat kryesore;
 - 1.7 Raportet e rregullta të Kryeprokurorëve ose Prokurorëve Mbikëqyrës;
 - 1.8 Rastet e zgjedhura nga prokurori;
 - 1.9 Vendimet disiplinore të formës së prerë, në rast të dënimit;
 - 1.10 Informatat statistikore të siguruara nga NJSHP;
 - 1.11 Çdo dokument tjetër që përmban informata objektive dhe relevante për veprimtarinë profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në vlerësimin e performancës së prokurorit, e cila mund të merret parasyshtë nga KVPP.

Neni 7
Mënyra e Zgjedhjes së Rastësishme të Rasteve

1. Lista e prokurorëve të cilët do të vlerësohen përgatitet në pajtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje, i dërgohet NJSHPP, i cili përgatit listën e lëndëve të kompletuara dhe listën e procesverbaleve të shqyrtimit kryesor në të cilën ka marrë pjesë prokurori gjatë periudhës së vlerësimit.
2. KVPP për zgjedh tetë (8) raste së bashku me procesverbalet e shqyrtimit kryesor (me short apo duke zgjedhur një nga dhjetë rastet në listë).

Neni 8
Raporti i Vlerësimit të Kryeprokurorit

1. Secili Kryeprokuror në baza vjetore, vlerëson performancën e secilit prokuror që punon në prokurorinë përkatëse.
2. Qëllimi i vlerësimit të bërë nga kryeprokurori është të:
 - 2.1 Vlerësoj performancën e prokurorit;
 - 2.2 Identifikojë mangësitë e performancës, dhe
 - 2.3 Propozojë masa për përmirësimin e përfomancës së prokurorit.
3. Raporti i vlerësimit të performancës i Kryeprokurorit do të përfshijë:
 - 3.1 Vlerësimin e prokurorit për vitin e kaluar në përputhshmëri me kriteret dhe treguesit siç janë përcaktuar me këtë Rregullore dhe formën e vendosur në Shtojcën 1, dhe
 - 3.2 Propozimin e masave shtesë, përfshirë trajnimet për përmirësimin e performancës.
4. Kryeprokurori mban takim me secilin prokuror individualisht para se të dorëzojë raportin.

Neni 9
Burimet e Informacionit për Vlerësimin e Kryeprokurorëve

1. Për vlerësimin e Kryeprokurorëve dhe të prokurorëve në pozita menaxhuese do të përdoren burime të informacionit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e prokurorisë përkatëse, duke përfshirë:
 - 1.1 Planin Vjetor të Prokurorisë përkatëse;
 - 1.2 Mbledhjen Vjetore të Kryeprokurorëve;
 - 1.3 Raportet Tremujore të Kryeprokurorëve;
 - 1.4 Raportete NJSHPP për Prokurorinë përkatëse;
 - 1.5 Raportet e rregullta të Kryeprokurorëve.

- 1.6 Çdo dokument tjetër që përmban informata objektive dhe relevante për veprimtarinë profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në veprimtarinë profesionale të prokurorit, që mund të merret parasyshë nga KVPP.

Neni 10

Burimet e Informacionit për Vlerësimin e Prokurorëve në fund të trajnimit fillestar

1. KPK mund të kërkojë nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) raportet lidhur me procesin e vlerësimit të prokurorëve në fund të trajnimit fillestar.
2. Gjatë vlerësimit të prokurorëve në fund të trajnimit fillestar, burimet e informacionit që përdoren, përfshijnë si vijon:
 - 2.1 Raportet e përgatitura nga prokurorët mentorë gjatë trajnimit fillestar në IGJK;
 - 2.2 Punimet e përgatitura nga prokurorët gjatë trajnimit fillestar, duke përfshirë raportet, draft vendimet dhe rastet studimore (maksimum 10 dokumente);
 - 2.3 Raportet përfundimtare të IGJK-së, dhe
 - 2.4 Komentet e prokurorit në trajnim në raportin përfundimtar.
 - 2.5 Çfarëdo elementi tjetër relevant dhe objektivisht i verifikueshëm, siç është njohja e një gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, kontributet akademike, ushtrimi i aktivitetit profesional (psh avokat, pjesëmarrja në projekti vendore ose ndërkombëtare si ekspert).

Neni 11

Njohuria Profesionale, përvoja e punës dhe performanca, duke përfshirë njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut

1. Ky kriter vlerësohet në bazë të treguesve kuantitativ dhe kualitativ në vijim:
 - 1.1 Treguesit kuantitativ për matjen e këtij kriteri janë si vijon:
 - 1.1.1 Niveli i plotësimit të normës vjetore duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e lëndëve në vlerësim;
 - 1.1.2 Raportin mes kallëzimeve penale të pranuar dhe të hedhura;
 - 1.1.3 Raportin mes aktakuzave të pranuar, të kthyera për plotësim dhe të refuzuar, nga gjykata;
 - 1.1.4 Raportin mes aktakuzave të parashtruara dhe vendimeve/aktgjykimeve gjyqësore dhe liruese;
 - 1.1.5 Raportin mes ankesave të aprovuara dhe të refuzuara kundër vendimeve/aktgjykimeve të gjykatës;
 - 1.1.6 Raportin mes ankesave të aprovuara dhe/ose refuzuara kundër aktgjykimeve;
 - 1.1.7 Raportin mes mjeteve të jashtëzakonshme juridike të aprovuara dhe të refuzuara që janë parashtruar.

2. Treguesit kualitativ për matjen e këtij kriteri janë si vijon:

- 2.1 Aftësia për arsyetimin e kërkesave për caktimin e masave për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë (paraburgimi, arresti shtëpiak, etj);
- 2.2 Aftësia për fillimin/pezullimin e hetimeve;
- 2.3 Aftësia për kualifikimin adekuat të veprës penale;
- 2.4 Aftësia për mbrojtjen e rastit para gjykatës; dhe
- 2.5 Përvoja e punës.

Neni 12

Kapaciteti dhe aftësia për analizimin e problemeve ligjore dhe zotësia për arsyetim ligjor

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Njohja e ligjeve të aplikueshme;
- 1.2 Aftësia për kualifikimin e veprave penale në mënyrë adekuate;
- 1.3 Aftësia për përfshirjen e fakteve sipas dispozitave përkatëse;
- 1.4 Aftësia për analizimin e ligjeve sipas metodave sistematike dhe koherente;
- 1.5 Kapaciteti për grumbullimin e provave/fakteve sipas implikimeve ligjore;
- 1.6 Kapaciteti për vlerësimin dhe arsyetimin e provave të grumbulluara lidhur me veprën penale.

Neni 13

Aftësia profesionale

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Vetiniciativa;
- 1.2 Puna ekipore;
- 1.3 Aftësia për menaxhimin e rasteve dhe kohës;
- 1.4 Shkathtësia e marrjes në pyetje (drejtpërdrejtë dhe tërthortë);
- 1.5 Përdorimi i teknologjisë informative;
- 1.6 Personaliteti i fortë dhe vetë-kontrolli;
- 1.7 Gatishmëria për të zhvilluar shkathtësitë profesionale përmes trajnimeve;
- 1.8 Pjesëmarrja në aktivitete tjera (tryeza pune, grupe punuese, etj.)
- 1.9 Gatishmëria për zëvendësimin e prokurorëve tjerë;
- 1.10 Kapaciteti për marrjen e iniciativës në rastet e tjera kur vepron si prokuror zëvendësues;
- 1.11 Gatishmëria për të punuar si prokuror kujdestar, dhe
- 1.12 Aftësitë menaxheriale dhe organizative (vetëm për Prokurorët në pozita menaxheriale).

Neni 14

Aftësia për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, ndërgjegjshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi

1. Kriteri që ka të bëjë me kryerjen e detyrave në mënyrë të paanshme, ndërgjegjshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Pavarësia dhe paanshmëria;
- 1.2 Ndershmëria, sinqeriteti dhe besueshmëria;
- 1.3 Sjellja e mirë dhe karakteri;
- 1.4 Fuqia e personalitetit dhe vetëkontrolli, dhe
- 1.5 Respektimi i Kodit të Etikës.

Neni 15

Aftësitë e komunikimit

1. Kriteri që ka të bëjë me aftësitë e komunikimit do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Aftësia për sigurimin e saktësisë, qartësisë dhe njëtrajtshmërisë në dokumentet e shkruara;
- 1.2 Aftësia për paraqitjen e fakteve në seanca dëgjimore dhe për paraqitjen në seanca gjyqësore, dhe
- 1.3 Aftësia për ndërveprimin me publikun dhe palët në procedurë në mënyrë profesionale.

Neni 16

Sjelljet jashtë zyrës

1. Kriteri që ka të bëjë me sjelljet jashtë zyrës, do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Respektimi i standardeve të sjelljes brenda dhe jashtë zyrës për aq sa ndikon në veprimtarinë profesionale të prokurorit;
- 1.2 Vlerësimi i aktiviteteve plotësuese, dhe
- 1.3 Vlerësimi i konflikteve eventuale të interesit.

Neni 17

Integriteti personal

1. Kriteri që ka të bëjë me integritetin personal, do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Dinjiteti, sinqeriteti, besueshmëria;
- 1.2 Respektimi i diversitetit (shumëllojshmërisë); dhe
- 1.3 Përshtatshmëria.

Neni 18
Metoda e vlerësimit

1. Vlerësimi i përgjithshëm i prokurorëve bëhet në bazë të vlerësimit të punës sipas kritereve të përcaktuara në ligj dhe treguesve përkatës.
2. Vlerësimi kuantitativ i punës së prokurorëve do të bazohet në të dhënat statistikore dhe nivelin e plotësimit të normës vjetore siç është përcaktuar me udhëzimin administrativ të KPK-së mbi normën orientuese vjetore për punën e prokurorëve duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rasteve nën vlerësim.

Neni 19
Mandati i KVPP-së

Komisioni për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve (KVPP) është komision i përhershëm i KPK-së, që është kompetent për kryerjen e procedurës së vlerësimit për të gjithë prokurorët e shtetit.

Neni 20
Kompetencat e KVPP-së

1. KVPP ka kompetencë vlerësimin e përformancës së prokurorëve gjatë mandatit fillestar dhe vlerësimin e rregullt të prokurorëve, në bazë të procedurave të përcaktuara me ligj, këtë Rregullore dhe aktet e tjera të miratuara nga KPK.
2. Në ushtrimin e aktiviteteve të tij, KVPP do të ketë qasje në informatat, dosjet, lëndët dhe statistikat e plota të prokurorit që i nënshtrohet procesit të vlerësimit.
3. Pas përfundimit të vlerësimit, KVPP propozon notimin e prokurorit sipas niveleve: pamjaftueshëm, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë.
4. KVPP nxjerr një raport përfundimtar me propozimin për vlerësim të prokurorit përkatës, raport që dorëzohet në KPK, jo më shumë se një muaj pas vlerësimit.
5. KPK vendos për vlerësimin përfundimtar të prokurorëve.

Neni 21
Përbërja e KVPP

1. KVPP përbëhet nga tre (3) anëtarë që zgjedhën nga KPK si vijon:
 - 1.1 Një anëtar nga radhët e prokurorëve anëtarë të KPK-së, i cili do të jetë Kryesues i KVPP-së;
 - 1.2 Një anëtar nga radhët e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, dhe

1.3 Një anëtar nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit.

2. KVPP do të ketë të paktën tre (3) anëtarë zëvendësues të cilët ftohen në rast të mungesës së anëtarëve të përhershëm për arsye objektive ose nëse anëtarët e përhershëm kanë konflikt të interesit. Pas propozimit të Kryesuesit, KPK mundet të zëvendësojë përkohësisht një anëtar të KVPP kur ai anëtar nuk mund të kryej detyrën e tij/saj.
3. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të KVPP-së kanë mandat po aq sa zgjatë edhe mandati i anëtarit të KPK-së.
4. KPK me vendim të veçantë mund ta angazhojë njërin nga anëtarët e KVPP-së me punë të përhershme në KVPP dhe të njëjtin ta lirojë nga angazhimet si prokuror.
5. KPK-ja do të themelojë KVPP-në brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore.

Neni 22

Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i KVPP

1. KVPP-ja udhëhiqet nga Kryesuesi.
2. Anëtarët e KVPP-së zgjedhin zëvendësin e Kryesuesit.
3. Zëvendëskryesuesi ka të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit në mungesë të tij.

Neni 23

Reduktimi i punës së anëtarëve të KVPP

1. Kryesuesi dhe anëtarët e KVPP-së do të ngarkohen me 30% më pak lëndë se norma vjetore e tyre.
2. Përjashtimisht, nëse KPK-ja vendosë që njëri nga anëtarët të jetë i angazhuar me punë të përhershme, atëherë nuk do të zbatohet paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 24

Mbështetja administrative për KVPP

1. NJSHPP-ja i ofron mbështetje administrative KVPP-së.
2. NJSHPP-ja do të mbledhë dhe përgatisë të gjitha informatat statistikore dhe informatat e tjera të nevojshme kur kërkohen nga KVPP.
3. Gjatë procesit të vlerësimit, NJSHPP do të përgatisë raportet individuale për secilin prokuror të cilat ia dorëzon KVPP.
3. KPK-ja cakton një anëtar të personelit të NJSHPP-së si sekretar të KVPP-së.

Neni 25
Takimet e KVPP

1. KVPP-ja në parim mban takime të paktën një herë në muaj. KVPP-ja mund të mbaj takime kurdo që e konsideron të nevojshme.
2. Takimet e KVPP-së udhëhiqen nga kryesuesi, ndërsa në mungesë të tij zëvendës kryesuesi udhëheqë me takimin e KVPP.
3. Kryesuesi në konsultim me anëtarët e KVPP-së përcaktojnë orarin e takimeve në përputhje me kërkesat e punës të KVPP-së.

Neni 26
Votimi

1. Vendimet e KVPP-së merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KVPP-së.
2. Raportin e vlerësimit e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e KVPP-së.

Neni 27
Informatat dhe Raportet për Vlerësim

1. Çdo prokuror duhet të siguroj informata për punën dhe performancën e tij në regjistrin online të përgatitur nga NJSHPP, sipas rregullave dhe procedurave të përpiluara nga NJSHPP.
2. NJSHPP do mbledh të gjitha raportet dhe informatat për prokurorin i cili i nënshtrohet procedurës së vlerësimit dhe i dorëzon në KVPP për vlerësim të prokurorit.

Neni 28
Inicimi i Procedurës së Vlerësimit

1. NJSHPP-ja rregullisht njofton KPK-në lidhur me prokurorët që duhet t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit;
2. Pas vendimit të KPK-së për grupin të prokurorëve që do t'i nënshtrohen vlerësimit të performancës, NJSHPP-ja do të përgatitë listën e prokurorëve që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe ia dorëzon Kryesuesit të KVPP-së së paku tre (3) muaj para përfundimit të periudhës të mandatit fillestar.
3. Pas pranimit të listës së prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vlerësimit, Kryesuesi i KVPP e informon secilin prokuror që do t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit.

4. NJSHPP-ja përgatit dokumentacionin dhe informatat e nevojshme për vlerësimin e prokurorit gjatë mandatit fillestar si dhe e informon KVPP-në.
5. Për qëllime të vlerësimit të rregullt që kryhet çdo tre (3) vite, NJSHPP do të identifikojë në baza vjetore prokurorët që duhet të vlerësohen në fund të çdo viti përkatës dhe e informon Kryesuesin e KPK-së dhe KVPP-së për këtë;
6. NJSHPP-ja do të sigurojë të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e vlerësimit.

Neni 29 Vetëvlerësimi

1. Prokurori i cili i nënshtrohet procedurës së vlerësimit është i obliguar që t'i dorëzojë KVPP-së raportin e vetë-vlerësimit sipas Shtojcës 2, dhe tetë (8) raste të përzgjedhura nga ana e tij, brenda afatit të përcaktuar nga KVPP-ja.
2. Prokurori gjithashtu ka të drejtë që fizikisht të prezantojë numrin e të gjitha rasteve për periudhën për të cilën vlerësohet.
3. Prokurori e dorëzon raportin e vetë-vlerësimit së bashku me lëndët e përzgjedhura tek KVPP-ja.

Neni 30 Vlerësimi nga Kryeprokurori

1. Në bazë të njoftimit të NJSHPP, kryeprokurori dorëzon raport për secilin prokuror që punon në prokurorinë përkatëse, deri me datë 31 janar të vitit përkatës.
2. Raporti i Kryeprokurorit sipas formularit në Shtojcën 1, do të përdoret për secilin raport të vlerësimit;
3. Raporti i kryeprokurorit do të përfshijë edhe komentet e prokurorit të vlerësuar;
4. Administratori i Prokurorisë do të dërgojë në NJSHPP raportin dhe dokumentet e bashkëngjitura brenda afatit të përcaktuar nga KVPP. Administratori dhe NJSHPP do të konfirmojnë datën e dërgimit dhe datën e pranimit. Për këtë qëllim mund të krijohet një regjistër i veçantë. Mund të përdoren edhe mjetet e komunikimit elektronik të dokumenteve.

Neni 31 Vlerësimi nga KVPP

1. KVPP-ja pas pranimit të informatave të nevojshme nga NJSHPP, raportin e vlerësimit të kryeprokurorit, vetë-vlerësimin e prokurorit dhe dokumentet tjera relevante, do të bëjë vlerësimin e prokurorit.

2. KVPP-ja mund të kërkojë informata shtesë nga NJSHPP-ja, kryeprokurori i prokurorisë përkatëse ose nga vetë prokurori. Në rastet e kërkesave për informata shtesë, procesverbali i takimit do t'i bashkëngjitet raportit përfundimtar.
3. Të gjitha informatat shtesë të kërkuara nga KVPP-ja do të sigurohen nga NJSHPP-ja.
4. KVPP-ja pas vlerësimit të prokurorit sipas formularin të shtojcës 3 nxjerrë raport përfundimtar dhe e procedon në KPK. Njëkohësisht me raportin njoftohet edhe prokurori përkatës.
5. KVPP-ja mund të rekomandojë KPK-së masa shtesë për përmirësimin e performancës së prokurorit.
6. Përveç vlerësimit të rregullt të performancës së prokurorëve, Kryeprokurori i Shtetit me aprovimin e KPK-së mund të kërkojë vlerësim nga KVPP-ja për prokurorin përkatës, në rastet kur Kryeprokurori i Shtetit konsideron se prokurori me rastin e vendosjes së lëndëve ka bërë lëshime profesionale të rënda.
7. Në qoftë se KVPP-ja gjatë vlerësimit të performancës së prokurorit sipas kërkesës së Kryeprokurorit të Shtetit vlerëson se i njejtë ka bërë lëshime të rënda profesionale, e njofton Komisionin Disiplinor të KPK-së për fillimin e procedurës disiplinore.

Neni 32

Kundërshtimi i prokurorit për vlerësimin e KVPP

1. Prokurori i vlerësuar ka të drejtë që të ketë qasje në dokumentet në bazë të të cilave bëhet vlerësimi si dhe të kundërshtojë raportin e KVPP-së pranë KPK-së, brenda shtatë (7) ditëve pas pranimin të tij.
2. KPK-ja vendosë lidhur me kundërshtimin nga paragrafi 1 i këtij neni, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. KPK-ja gjithashtu, mund të ftojë në dëgjim kundërshtuesin e raportit të KVPP-së.

Neni 33

Vendimi i KPK-së

1. KPK-ja vendosë për vlerësimin e prokurorit sipas notave: pamjaftueshëm, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë. Vendimi duhet të merret brenda 30 ditëve pas pranimin të raportit përfundimtar të KVPP-së.
2. KPK-ja mund të kërkojë informata shtesë nga kryeprokurori ose prokurori i ngarkuar me detyra menaxhuese, KVPP-ja dhe ta intervistojë prokurorin. Procesverbali i çdo interviste deponohet në dosjen përkatëse.

3. Vendimi i KPK-së i komunikohet prokurorit së paku shtatë (7) ditë pas marrjes së vendimit dhe përfshihet në dosjen personale të prokurorit.

Neni 34

Pasojat e vlerësimit të prokurorëve

1. Kur vlerësimi i prokurorit është i nivelit të pamjaftueshëm dy (2) herë rradhazi, atëherë KPK mund të vendosë uljen në detyrë apo edhe propozimin për shkarkim.
2. Kur vlerësimi i prokurorit është mjaftueshëm paraqet arsye për dërgim të prokurorit në trajnime të detyrueshme.
3. Me rastin e propozimit të kandidatit për pozitën e kryeprokurorit, KPK-ja do ta merr për bazë vlerësimin e përfundimtar, respektivisht notën dhe numrin e poenave të prokurorit në fjalë.

Neni 35

Konfidencialiteti

1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në ligjet dhe rregulloret tjera, të gjitha shënimet dhe informatat që mbliidhen ose mbahen gjatë procesit të vlerësimit janë konfidenciale dhe nuk zbulohen, përveç nëse është kërkuar ndryshe nga prokurori në vlerësim.
2. Sekretari i KVPP-së pas miratimit të raportit përfundimtar nga ana e KPK-së, do të vendosë në dosjen e prokurorit raportin e vetëvlerësimit, raportin e kryeprokurorit dhe raportin e KVPP-së.

Neni 36

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit nga KPK.

Prishtinë më, 29 dhjetor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës
Kryesues, Aleksandër Lumezi



The image shows a circular official stamp of the Kosovo Prosecutorial Council (KPK). The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'Këshilli Prokurorial i Kosovës' around the inner edge, and 'Prishtinë - Pristina' at the bottom. In the center is the coat of arms of Kosovo. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Aleksandër Lumezi'.